

Pylltarët të jetojnë në bashkësi, si grumbulli pyjor

- *Meditime, me rastin e 16 shkurtit - Ditës së Inxhinierit të Pyjeve* -

Nga Kristo KAURI



pasur ide dhe koncepte të qarta për profesionin e inxhinierit të pyjeve, metoda me e mirë, me e shpejtë, është t'i studiosh e ballafaqosh në natyrë, në pyje këto njohuri.

Le t'u heqim kapelën shkencëtarëve, Theofrastit, Gëtes, Darvinit, Lineut ... për veprat dhe kontributin e tyre për të njohur natyrën. Por, për të njohur drurët dhe pyllin, botën mistike e magjike të tyre, duhet të ngjitemi në male. Vetëm midis maleve, që përqafohen nga agimet e kuqe dhe perëndimet e arta, të krijohet ky privilegj.

"Libri" i natyrës është me i qarti, më i sakti për ta lexuar, nëse ke dëshirë ... Një i ri apo e re që do të bëhet pylltar, inxhinier pyjesh, duhet të ngjitet me dë-

shirë e vullnet maleve, të vëzhgojë, të studiojë në çdo stinë dhe në çdo orë natyrën. Duke vëzhguar natyrën, bukurinë e saj, peizazhet, duke komunikuar me Mbretërinë e gjelbër, duke thithur oksigjenin e pastër, zemra dhe shpirti të drithërohen dhe, natyrshëm, do të falënderosh Zotin për gëzimin e lumturinë që të ofron. Kush nuk provon e nuk shijon këto emocione magjike, për mendimin tim është më mirë të mos bëhet pylltar dhe, nëse është, të ndërrojë profesion sa me shpejt. Përveç dëshirës, pasionit dhe përvojës duhet dhe përgatitje e mirë fizike. Nëse fiziku, shëndeti, përballon këtë dëshirë,

Vijon në fq. 3

Kur nisa punë inxhinier pyjesh në Malësinë e Gjakovës (Tropojë), dija shumë pak për jetën mistike të drurëve dhe për botën magjike të Natyrës. Vëmendja jonë si specialistë, përqendrohej tek administrimi, mbarështimi dhe trajtimi i pyjeve për prodhimin e materialit drusor dhe kjo nuk ishte e pakët. Shumë mirë është të lexosh se mëson shumë gjëra, por për të

Projekti S.W.A.N

(Platforma digjitale për ripërdorimin e mbetjeve të ngurta për Ballkanin)

Nga Abdulla DIKU



Objektivi

Të organizojë e ndërlidhë (industrialisht dhe nga ana tregtare) prodhuesit e mbetjeve brenda rajonit, një vendi dhe/ose midis vendeve të Ballkanit, për të ripërdorur, ricikluar e rigjeneruar mbetjet e tyre në material të lëndës së parë për industrinë e tjera.

Qëllimi

Menaxhimi i materialeve, si mjet për zvogëlimin e ndikimeve të mbetjeve dhe reduktimin e inputeve të lëndëve të para në ekonomi (Direktiva 2008/98 / EC), është direktiva bazë në të cilën mbështeten qëllimet e projektit. si më poshtë:

- Të reduktojë ndotjen e ambientit, nëpërmjet devijimit të volumit të mbetjeve të ngurta jo të rrezikshme, të cilat groposen apo depozitohen.
- Të reduktojë sasinë e importeve të lëndëve të para.
- Të reduktojë kostot për industrinë.
- Të pakësojë gazet serrë (GHG).

Partneret e Projektit

- Asociacioni i Komunave në Rajonin e Atikës – Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta (EDSNA).
- Ministria Greke e Mjedisit dhe Energjisë.
- Universiteti i Egjeut / Njësia e Kërkimit / Departamenti i Administrimit të Biznesit.
- Ministria Shqiptare e Turizmit dhe Mjedisit.
- ILIRIA / Shoqata për Mbrojtjen dhe Zhvillimin Mjedisor & Social.
- Shoqata Industriale Bullgare – Bashkimi i Biznesit Bullgar.

Vendndodhja e aktiviteteve

Projekti do të mbulojë: Greqinë, Shqipërinë, Qipron dhe Bullgarinë.

Aktivitetet në Shqipëri

Veçanërisht në Shqipëri është sfida e shtuar e mungesës së strategjive kombëtare ose rajonale për menaxhimin efektiv të mbeturinave të ngurta, të cilat gjenerimi vjetor i mbe-

"Projekt i bashkëfinancuar nga BE dhe Fondet Kombëtare të vendeve pjesëmarrëse"

Vijon në fq. 3

Në shtator 2017, ka filluar të zbatohet Projekti S.W.A.N (Platforma digjitale për ripërdorimin e mbetjeve të ngurta për Ballkanin), i bashkëfinancuar nga Programi Ndërkombëtar i Bashkëpunimit Interreg V Balkan-Mediterranean 2014-2020, nëpërmjet Bashkimit Evropian dhe Fondeve Kombëtare të vendeve pjesëmarrëse të tij. Buxheti total është 968.000 EUR dhe kohëzgjatja dy vjet.

Vizioni

Zhvillimi i një Platforme Interaktive TI midis vendeve të Ballkanit dhe pellgut të Mesdheut, e cila do të krijojë lokalisht dhe do të menaxhojë midis vendeve pjesëmarrëse, zinxhirë vlerash për mbetjet e ngurta jo-të rrezikshme, duke promovuar në këtë mënyrë rritjen e gjelbër brenda një ekonomie qarkulluese, drejt një shoqërie me zero mbetje.

Inventari Kombëtar i Pyjeve 2018-2019

- *Përpunimi i të dhënave të fazës së parë të terrenit, sfida e radhës* -

Kliti STARJA - Bilena HYSENI

Ubënë mëse dy vjet e gjysmë që ekipi i AKM-së udhëheq projektin e ngritjes së kapaciteteve dhe kryerjes së Inventarit Kombëtar të Pyjeve e Kullotave 2018-2019. Në këtë rrugëtim, së bashku me 18 specialistë nga AdZM-të e rretheve, ndihmuar nga ekipi Suedez FSA & SLU, me financim të Bankës Botërore, përpos realizimit të objektivave, janë hasur vështirësi dhe sfida të njëpasnjëshme.

Duke dashur të informojmë publikun rreth procesit të inventarit Kombëtar, nëpërmjet këtij shkrimi do të përpiqemi t'u përcjellim çështjet me interes të gjerë, por edhe ato teknike, për specialistët e pyjeve, që janë në pritje të rezultateve të



kësaj sipërmarrjeje, sa sfiduese aq edhe të vështirë.

Të dhënat e inventarit Kombëtar të Pyjeve dhe Kullotave sigurojnë informacion të saktë në lidhje me madhësinë, shpërndarjen, përbërjen dhe gjendjen e pyjeve dhe kullotave. Këto të dhëna evidentojnë gjithashtu dinamikën e ndryshimeve midis dy apo më shumë inventarëve dhe shërbejnë si bazë e plotë statistikash për inventarët e tjerë në të ardhmen. Në shkrimet e mëparshme kemi përcjellë punën e bërë për ngritjen e kapaciteteve të ekipit të IKKP, si dhe përmbushjen e një sërë kushtesh tekniko-organizative, që i paraprijnë punës në terren dhe përpunimit statistikor të të dhënave të grumbulluara gjatë fazës së parë të matjeve (qershor-tetor 2018). Kështu është bërë i mundur hartimi i metodologjisë, që do të ndiqet për ngritjen e rrjetit të monitorimit, kryerjen e procesit të pavarleresimit, mënyrën e matjes dhe grumbullimit të të dhënave, periodicitetit të matjeve dhe përpunimit statistikor të tyre. Formatit digjital i grumbullimit dhe transferimit të të dhënave "OPEN FORIS" përmirëson punën e grumbullimit dhe regjistrimit të të dhënave, si dhe ndihmon procesin e përpunimit statistikor, duke shmangur shumë gabime të mundshme në krahasim me metodën manuale.

Rrjeti i përhershëm i monitorimit, i dizenuar në rrjetin kilometrik 500m x 500m përbëhet nga 1100 klastera, që sipas mundësisë dhe kapaciteteve mund të shtohet në inventarët e tjerë.

Vijon në fq. 5

Njoftim!

Redaksia e gazetës "Kurora e Gjelbër", ka hartuar një projekt për ribotimin e veprës madhore "Drurët dhe shkurret e Shqipërisë" me autor Bashkëpunëtorin e Vjetër Shkencor Ilija MITRUSHI, duke i ruajtur autorësinë. Ribotimi do të bëhet nën kujdesin e një Redaksie të posaçme. Ftojme Fakultetin e Shkencave Pyjore, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (Drejtorinë e Pyjeve), Sektorin e Pyjeve pranë Ministrisë së Turizmit e Mjedisit, Bankën Botërore, REC-un, CNVP-në, INCA-n, Kompanitë që operojnë në fushën e pyjeve, AKZM-në, Projektin e Shërbimeve Mjedi-sore, etj., që të bashkojnë kontributet për ribotimin e kësaj vepre shumë të rëndësishme për sot dhe për të ardhmen. Për përjetësimin e figurës së shkencëtarit të paharruar Ilija MITRUSHI, me të ardhurat nga shitja e këtij libri do të krijohet një pyll me emrin e tij.



Gazeta "Kurora e Gjelbër"

Cel. 068 42 17 939
klubiekologjik@gmail.com



Pylltarët të jetojnë në bashkësi, si grumbulli pyjor

Vijon nga fq. 1



pasion, nuk keni për ta lenë kurrë këtë profesion, ai është nga më të bukurit. Ky pasion të bën që të "martohesh" me natyrën, me pyllin me Mbretërinë e gjelbër. Bëhet fjalë për martesë për gjithë jetën, pa qenë rreziku i divorcit me këtë profesion të mrekullueshëm. Vetëm kështu natyra të jep gjithë magjinë dhe sekretet e saj dhe kërkon si këmbim vetëm dashuri. Nëse nuk e shikon, nëse ti nuk e përcjell këtë dashuri, punon angari, ajo nuk të jep asgjë, bile të përçmon me neveri dhe hakmerret ndaj teje.



Edhe unë, gradualisht në këtë rrugëtim, në kontakt e komunikim me pyllin, natyrën, me profesorët dhe inxhinierët e pasionuar, me librat, me revistat e huaja ..., nisa të lexoj me shumë dëshirë e pasion "Librin e madh" të natyrës. Edhe drurët e shtrembër, të thatë, të sëmurë, të kalbur, të shkurtër, të rrëzuar ..., na ngjallnin emocione, interes, i shikonim e i vlerësonim si pjesë e rëndësishme e ekosistemit. Duke komunikuar me pyllin, me këtë organizëm gjigant, shumë pikëpyetje që kishim merrnin zgjidhje, por shumë të tjera lindnin, si filizat e pyllit. Ky rrugëtim, midis së njohurës e të panjohurës, magjikes dhe të fshehtës, u bë shumë interesant dhe një sfidë e vërtetë. E keni vënë re kur udhëtoni në pyll, sa bukur rrinë drurët e mëdhenj - prindër, me drurët bij? Krijojnë një bashkësi, ndihmojnë dhe mbrojnë njëri-tjetrin, nuk e braktisin shtëpinë e tyre. Krijojnë një masiv, që vështirë të çahet e dëmtohet. Ata bashkëpunojnë dhe ndihmojnë njëri-tjetrin në momente kritike. Në gjithë këtë rrugëtim miliona vjeçar kanë evoluar, janë përshtatur dhe kanë programuar zhvillimin e tyre qelizor në mënyrë përsosur. Vetë drurët mësuan gjatë viteve, se në shoqëri, kur je i bashkuar, është më mirë se kur je i veçar. Një dru i vetëm nuk mund të ndikojë në mjedis, në klimë. Ai është i brishtë ndaj

furtunave, erërave, ngricave, vapës ... Kur janë bashkë ndihmojnë, bashkëveprojnë dhe grumbullojnë sasi të mëdha uji, bile nuk lenë asnjë pikë të shkojë kot, sigurojnë sasi të mëdha ushqimi, prodhojnë më shumë oksigjen, biomasë, rriten e zhvillohen më shumë, janë më të lumtur. Bile dhe ata që vdesin e nuk përballojnë jetën, kthehen në ushqim dhe ndihmojnë në jetën e bashkësisë. Nëse çdo dru do të kujdesej për vete, nuk do të kishte privilegjin që të plakej, por do të vdiste, do të rrëzohej e, për rrjedhojë, do të krijoheshin boshllëqe, çeltira, ku "armiku", furtunat, vapa, ngricat ... do të depërtonin më lehtë dhe do të rrëzonin gjithë pyllin. Pylli e mësoi shumë mirë këtë sekret të jetës së tij pas shumë dështimeve dhe lufton që ta ruajë këtë bashkësi e komunitet me çdo kusht. Drurët e shëndoshë ndihmojnë të sëmurët që të rimarrin veten dhe nesër ndodh e kundërta ... Rivaliteti, lufta për hapësirë, për diell, për tokë është e ashpër. Kjo luftë nuk pranon shenja dembelizmi, humbje kohe, është motori lëvizës, që ky organizëm gjigant zhvillohet dhe lartohet drejt qiellit, por në të njëjtën kohë pjesa më inteligjente ecën në drejtim të kundërt, duke u futur thellë në tokë për të gjetur ushqim dhe për të mbajtur në këmbë krijesën magjike të Zotit, Drurin.



Në këtë ditë feste të pylltarit, ne specialistët e pyjeve, që njohim më mirë se kushdo tjetër këtë ligjësi të pyllit, na çudit fakti që kemi zgjedhur të jetojmë kështu, të veçar e jo në bashkësi, si grumbulli pyjor ... Të ndarë, pa bashkëpunim njëri me tjetrin, gjatë gjithë rrugëtimit, nuk kemi përballuar dhe nuk mund të përballojmë "furtunat" dhe "ngricat", që po kalon pylltaria dhe pylltarët. Ajo, edhe për fajet, mentalitetin e përgjegjësinë tonë, ndodhët në udhëkryq, pa strategji, pa modele, e braktisur dhe në degradim të plotë. Gëzuar festën të dashur kolegë

REGJISTRIMI I PYJEVE DO TË FRENOJË SHFRYTËZIMIN

Sektori i Pyjeve ka qenë vazhdimisht objekt i ndryshimeve si rezultat i reformës territoriale, decentralizimit apo programeve të tjera institucionale. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka ndërtuar një strategji të qëndrueshme dhe analizë të thellë për projektin e regjistrimit të pyjeve e kullotave, që po zbatohet në të gjithë Shqipërinë, i cili do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në aspektin politik, ekonomik, social dhe ekologjik të vendit. Ministri Blendi Klosi u shpreh se është një proces jo i lehtë, proces që ka vite që projektohet, por tashmë jemi në fazën e hapave dhe rezultateve konkrete. Klosi dorëzoi certifikatat e para simbolike të pronësisë së pyjeve për Bashkinë e Kollonjë, duke shënuar kështu fillimin e një procesi për të gjithë vendin. Ministri Klosi theksoi se tashmë kryetarët e bashkive janë posedues realë në zyrat e



gjendjes civile të pyjeve dhe mund t'i shfrytëzojnë ato si pasuri të vërtetë. Sipas ministrit, krijimi i kësaj mundësie të re ligjore synon të frenojë deri në eliminimin përfundimtar shfrytëzimin informal të pyjeve e kullotave, por krijon edhe hapësira të reja për investime; do të rrisë numrin e të punësuarve, si dhe do të zhvillojë taksën e pasurisë së paluajtshme, si burim i rëndësishëm i të ardhurave të njëjësive të qeverisjes vendore.



Projekti S.W.A.N

Vijon nga fq. 1

turinave komunale, kryesisht nga familjet, por duke përfshirë mbetjet e ngjashme nga burime të tilla, si tregtia, zyrat dhe institucionet publike. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në Shqipëri, si institucioni përgjegjës për hartimin e strategjive dhe politikave në këtë fushë, do të jetë partneri kryesor i Projektit për vendin. Shoqata Iliria, si shoqatë mjedisore me ndikim të spikatur në advokimin e çështjeve të mprehta mjedisore, do të plotësojë kontributin e shoqërisë civile, veçanërisht të lidhur me grupet e interesit, industrinë dhe autoritetet lokale.

- 1. Kërkimi:** a) Garantimi i ndihmës për agjentët e menaxhimit të mbetjeve drejt identifikimit të mundësive të përbashkëta të biznesit dhe promovimit të bashkëpunimit akademik-industri, nëpërmjet aplikimit të dy algoritmeve për koordinimin e ofertës dhe kërkesës për mbetjet e ngurta; b) Zhvillimi i Hartave të Mbetjeve të Ngurta të Ballkanit SWAN, lidhja e aktorëve kombëtarë e trans-nacionalë dhe zhvillimi i qasjeve inovative drejt arritjes së përfitimeve të ekonomisë rrethore, përmes formulimit të raporteve të anketimit.
- 2. Transferim i njohurive:** Përfituesit e projektit dhe publiku i gjerë do të mësojnë rreth ekonomisë rrethore e simbiozës industriale dhe do të njihen me konceptin e zinxhirëve të vlerave të ripërdorimit të mbeturinave përmes punësive, faqes së internetit të projektit, gazetave, njoftimeve për shtyp, artikujve dhe mbulimit të shtypit. Ata do të inkurajohen të mësojnë e përdorin Ekosistemin Digjital SWAN (duke përdorur manualët operacionale e trajnimit dhe duke marrë pjesë në trajnime) dhe të punojnë drejt arritjes së objektivave më të gjerë të BE për ripërdorimin e mbeturinave.
- 3. zhvillimi i produkteve:** Përfituesit e Projektit do të jenë në gjendje të identifikojnë së bashku mundësitë (duke përdorur platformat dhe bazat e të dhënave) dhe të zhvillojnë modele të reja për shfrytëzimin e zinxhirëve të vlerave të ripërdorimit të mbetjeve transnacionale, nëpërmjet raporteve kombëtare të modelit të biznesit dhe modeleve të biznesit ndërkombëtar.
- 4. Qëndrueshmëria e rrjetit:** Ekosistemi industrial SWAN do të mbetet i lirë dhe aktiv pas përfundimit të Projektit dhe do të ndihmojë në ruajtjen e lidhjeve të ekosistemeve, do të kontribuojë në zgjerimin e saj në të gjitha vendet e Ballkanit, duke përfshirë aktorë të tjerë (institutet kërkimore, ndërmarrjet, OJQ, SME).

Pas një bashkëpunimi me partnerët, në shtator 2018 është zhvilluar kontributi i parë i Projektit SWAN, që ka të bëjë me Zhvillimin e një Platforme Digjitale të Mbetjeve të Ngurta \ Platforma e Ripërdorimit. Është përgatitur nga O.T.S. SA në qershor 2018 dhe është dorëzuar në shtator 2018 nga partneri i Projektit, Universiteti i Egjeut / Greçi. Nëpërmjet këtij kontributi kërkohet të arrihet qëllimi i krijimit të Ekosistemit Digjital SWAN, nëpërmjet zhvillimit të platformës SWAN dhe gradualisht integritet të hartës së mbetjeve të ngurta dhe algoritmeve të përputhjes zhytje-burim. Ky kontribut do të shërbejë si mjet për të hedhur themelet e zhvillimit të prototipit, që do të vijojë në fazat e mëvonshme të Projektit. Kontributi i shoqatës Iliria, do të jetë në popullimin e platformës, nëpërmjet pyetësorëve drejtuar autoriteteve lokale në Shqipëri.


www.facebook.com/SWANplatform

www.swan-interreg.com



Nga Fiqri SHAHINLLARI
Alexandria, Virginia (SHBA)

Vdekja e Lisit



Lisi i shenjtë rrojti edhe pesëdhjetë vjet pas vdekjes së Elimaqit. Erdhi një kohë kur edhe ai vdiq. Miqtë e tij, Plepi në Pulisht e shelgu në Gurisht, kishin kohë që e kishin mbaruar ciklin e vet por jeta e tyre, në një farë mënyre, vazhdonte sepse ata lanë filiza në rrënjët, që rriteshin e zëvendësonin njëri-tjetrin si trashëgimtarë. Po Lisin kush do ta pasonte? Në vendin ku ai ndodhej nuk kishte lëshuar filiza. Me lendet e tij, që binin poshtë trungut, ushqeheshin zogj e bagëti. Dhe për këtë fakt atij i vinte shumë keq. Rrojti sa deshi vërtet, por po ikte me pishmanllëk të madh. Nuk po linte trashëgimtarë. Po të kishte lënë pasardhës, vdekja do të ishte kapak floriri për jetën e mbaruar. Se, ja, i erdhi fundi edhe atij. Muajt i kishte të numëruar. Po i mbarohej ymri. Dhe fitili i jetës po lëkundej, gati për t' u fikur. Kishte kohë që fshatarët shihnin "qiqra jo të mbara" për Lisin. Ai po jepte shenja se do të vdiste së shpejti. Po mpakej, po bëhej një grusht. Degët e majës kishin vite që ishin tharë. Kjo damlla tharje zbriste ca sot, ca nesër, pak e nga pak, poshtë e më poshtë trungut të tij të plasarit thellë. Ai nuk kishte takat t' u dërgonte bisqeve e gjetheve lart ujë e kripëra të tokës, tretur në ujë. Në dimër pamja e shkretuar të shkaktonte keqardhje të madhe. Druri dukej krejt lakuriq, krejt i thatë! Copa të lëvozhgës së trungut, të plasarit, lëviznin lehtë dhe binin poshtë kur frynte erë e fortë. Dukeshin si lot të thatë, që qanin vetveten po edhe tokën që rriti Lisin. Që e bëri atë madhështor, të famshëm në tërë krahinën. Që e bëri të shenjtë. Edhe në pranverë dukeshin sikur gjethet e rralluara dilnin me përtesë. Ato mezi e vishnin me fletë trupin e tij të drobitur. Nuk dilnin si dikur, kur buisnin, mbushnin e vishnin me jeshillëk trungun dhe degët e tij, tamam si pushi dhe puplat që veshin shpendët.

Lisi e ndjente fundin e vet por, megjithatë, besonte se mund ta shtynte jetën e plakur, të mençme e shenjtoje, të paktën edhe nja dhjetë - pesëmbëdhjetë vjet të tjerë. Ai nuk e pandehte se do t' i vinte fundi kaq tragjikisht, siç i erdhi. Atë e vdiqën, nuk vdiq. Bashkësia e detyruar e fshatit i kishte hedhur zift afër trungut. Zifti pengonte depërtimin e shiut në rrënjët e lisit. Ujin ai mezi e merrte me rrënjët e tij të gjata dhjetëra metra larg, në veri të tij, ku ishte një sterrë në krye të një luadhi. Mbi zift vendosnin duajt e grurit, verzomat me fasule, me qëllim që të mos shkonin dëm kokrrat. Mbi degët e Lisit nuk dëgjoheshin më cicërima zogjsh. Mbi një degë të tij kishin varur një kambanë të madhe për alarme të ndryshme se, supozohej sikur gjoja jeta kanosej nga armiq përtej detesh e përtej malesh. Ato alarmet ishin të vërteta, por shkaqet ishin gënjeshtër. Këto alarme as që u afroreshin berihajeve të vërtetë të fshatit. Përkundrazi, tingujt alarmues të kambanës, tingujt e herëpashershëm të saj, i shurdhuan gjethet e Lisit, të cilat u mblodhën e u rrudhosën. Mbeti Druri i famshëm lakuriq. Dukej si një qenie e plevitosur nga e ftohta. Ai që kishte mbajtur "ngrohtë" me shekuj fshatin, tani mbeti vetë i plevitosur. U mërzi më tepër kur mori vesh se kudo në vend po priteshin pyje të tërë me ah, dushk e bredh. Po prisheshin kullota. Po dëmtohej natyrshmëria e jetës dhe botës bimore në tokë. Atëherë zemra e tij e madhe, e plakur, nuk duroi dot më. Plasi. U dogj. Nervit të jetës së tij, palcës në mes të trungut iu shtua temperatura, nga e cila shkrep një shkëndijë lart e palca mori flakë, siç merr fitili në brendësi të qiririt të dylltë. Dhe, kështu, Lisi i shenjtë, një natë u dogj nga brenda. Vdiq. Të nesërmen fshatarët panë me keqardhje hirin e tij. Hirin e Lisit të tyre të dashur. Fshati u pikëllua. Çdo fshatar që erdhi aty mori një grusht hi, akoma të nxehtë, në ngjyrë të argjendte dhe e lagte me lot ... Kishte ikur orakulli, "plaku" fatsjellës i fshatit. I miri. I shenjtë. I dërguari nga Zoti. Jetëshkullori. Kush e di sa breza njerëzish kishte pritur e përcjellë ky, shekullori dru i shenjtë! Rreth tij mblidheshin pleq të moçëm,

me gjithë mençurinë e përvojën e jetës. Atje vinin të rinj e të reja, e dukej sikur vinte energjia dhe e ardhmja. Vinin gra brezargjenta, ripërtëritëset e jetës. Njerëz të sëmure, që të gjenin shpëtim. Memecë, që të bëheshin me gojë ... të verbër ... Të lodhur nga jeta, që mbusheshin me shpresë për të ecur më tutje. Tani që po i vjen fundi këtij rrëfimi, natyrshëm më lind pyetja: Si thoni ju, të nderuar e të nderuara, qofshi në moshë të re apo të thyer, që lexoni apo dëgjoni këtë rrëfim të thurur me shtizat e fantazisë sime të ndezur qiellore, por që mbështetet në truallin tokësor. Pra, si mendoni, të mos jetë merakosur vallë Lisi i shenjtë se kush do të kujdeset pas tij për fshatin? Kush do ta mbrojë atë këtej e tutje? Të mos ketë marrë masa edhe për trashëgiminë e tij? U lutem, stop! Mos dyshoni aspak. Ka një testament prej tij. Shkruesi i kësaj rrëfenje është informuar se Lisi i madh e i shenjtë, kur ndeju fundin e vet, shpërndau pjesë-pjesë shenjtërinë e tij maleve e pyjeve, shkëmbinjve e gurëve, përrenjve e lumenjve, çezmave e koriëve, fushës e lëndinave. Testamenti i tij është ky amanet: "Në rast rreziku, të grumbullonin në një të vetëm pjesët e shenjtërisë, që shpërndau veç e veç, sa te njëri aq edhe te tjetri objekt, se bashkimi i tyre bën fuqinë dhe, nën komandën e Shkëmbit të Zërës, ta ngrinin Zërin e Berihajit të fshatit, për t' i bërë ballë të keqes". Ky ishte ligj. Ligjet, këtu poshtë, në tokë, janë shpikur nga njerëzit, nga hallet. Po aty, lart, në qiell, ligjet janë shpikur nga i Plotfuqishmi, për të ndihmuar hallemëdhentë e shumtë të kësaj bote, të kësaj jete. Sa për trashëgiminë e vet ai besonte se fëmijët e shkollës do ta gjejnë mënyrën për ta ripërtërirë Drurin gjysh, të shenjtë, për ta zëvendësuar atë, duke mbjellë ndonjë filiz të ri me gene dushku apo lende të lisave, rreth fshatit dhe t' i mbjellin pikërisht në vendin ku ai ka qenë. Mundet që ndonjë biznesmen fshati do të bëhet sebeb për të mbjellë aty ku ka qenë Lisi, një fidan me gjithë rrënjë, të marrë nga fidanishtet. Me këtë besim ai iku i lumtur në përjetësinë e vet ...


Lisi dru i shenjtë



Kaq shumë e kanë glorifikuar shqiptarët Lisin sa e kanë parë si simbol të qëndrueshmërisë dhe virtyteve njerëzore! Edhe keltët e lashtë e adhuronin Lisin. Adhuronin jetëgjatësinë e tij dhe e konsideronin si fisnike praninë madhështore të tij. Te keltët një person nderohej duke i vendosur kurorë me gjethe lisi, shenjë e statusit të veçantë. E njëjta gjë ndeshet edhe te grekët e lashtë dhe më vonë te romakët. Dhe të gjitha këto mund të shpjegohen thjeshtë me faktin se Lisi është një nga drurët më të dobishëm e më të përhapur në botë! Druri i tij është nga më të fortët. Siç thuhet: "I fortë e i qëndrueshëm si dru Lisi". Prandaj ka gjetur përdorim që nga kohët e lashta në ndërtim, si dhe për orendi shtëpiake, nga enët e kuzhinës e deri te mobilet. Gjetjet arkeologjike kanë provuar se Lisi ka qenë materiali kryesor drunor i përdorur për shtëpitë dhe orenditë shtëpiake që nga Neoliti. Mjafton të kundrohen me vëmendje kullat e vjetra në Malësitë tona, me çardakun e ahurin për kafshët, mjafton të shikohen mjetet e transportit, qerret e karrot, plugjet për lërimin e tokës, etj. Çardakët e kullave kanë qenë gdhendur prej dru lisi.



QARRI I OGRAJËS
"Quercus cerris"



Fotot marrë nga I. Seci

Vijon nga fq. 1

Tufat e dizenuara iu nënshtruan paravlerësimit me anë të analizës së ortofotove se cilës kategori të mbulesës së tokës i përket çdo sipërfaqe. Njëpërmjet paravlerësimit mundësohet përzgjedhja e vendeve të përshtatshme për të kryer matjet në terren, duke skualifikuar ato zona që nuk janë me interes për inventarin.



Paravlerësimi është një metodë që përcakton në shkallë të gjerë llojet e përdorimit të tokës, shpërndarjen e tyre dhe ndryshimin në të ardhmen të këtyre përdorimeve, si dhe jep mundësinë e përfshirjes së të gjitha sipërfaqeve me mbulesë pyjore apo kullësore, pavarësisht statusit ligjor të tyre. Arritje e rëndësishme e këtij projekti është përmblyllja me sukses e fazës së parë të matjeve të terrenit. Gjashtë grupet e punës realizuan matjen në 543 tufa (klastera) pjesë e serisë së parë të rrjetit T700. Grupet e punës gjatë realizimit të matjeve në terren u përballën me një sërë vështirësish, që kanë të bëjnë me mbërritshmërinë në pikë, referuar terrenit tepër të thyer, mungesës së rrugës auto në shumë raste, largësisë së pikës apo dhe mungesës së mjeteve të përshtatshme për rrugë tejet malore e me rrezik të lartë për sigurinë e lëvizjes. Specialistët e skuadrave të terrenit meritojnë një falënderim të madh, për sakrificat në përballimin e vështirësive, përkushtimin dhe profesionalizmin në realizimin e procesit të grumbullimit të të dhënave.

Të dhënat e grumbulluara janë transferuar në serverin qendror në kohe reale, duke kaluar përmes filtrave që ofron vetë sistemi nga ku realizohet dhe shkarkimi i tyre nga Ekipi i AKM në dy lloj formatesh, exel dhe cvs, të përshtatshme për përpunimet statistikore, në funksion të prodhimit të rezultateve të pritshme.

Krahas matjeve tremujore nga grupet e terrenit, ekipi kyç i AKM-së kreu kontrollin e cilësisë në 10 % të klasterave. Të dhënat e grumbulluara iu nënshtruan kontrollit statistikor të krahasueshmërisë, me anë të metodës "Cappa value" dhe "Pivot table", rezultatet e të cilave ishin brenda pritshmërive apo të një niveli të pranueshëm, çka tregon se procesi i matjeve përmbush cilësinë e kërkuar.

Inventari Kombëtar i Pyjeve 2018-2019

- Përpunimi i të dhënave të fazës së parë të terrenit, sfida e radhës -

Tashmë ekipi kyç ka në dorë bazën e të dhënave të terrenit, që përfshijnë:

- Të dhëna mbi përdorimin e tokës, mbulesën e vegjetacionit, përbërjen llojore, menaxhimin e sipërfaqes pyjore, veçoritë e tokës, prerjet etj.
- Të dhëna për tregues dendrometrik të drurit.
- Të dhëna mbi shkurret.
- Të dhëna mbi ripërtëritjen e pyjeve.
- Të dhëna mbi bimët aromatike-mjekësore (llojet, mbulesa).

Si dhe shumë të dhëna të tjera mbi drurët e thyer, të rrezuar apo të thatë, që do të shërbejnë si bazë e një sërë rezultatesh, që do të gjenerojë Inventari Kombëtar i Pyjeve dhe Kullotave. Për ngritjen e kapaciteteve të ekipit kyç të AKM-së në përpunimin statistikor të të dhënave, gjatë periudhës 11-15 mars 2019 u organizua workshopi i radhës mes ekipit kyç të Drejtorisë së Pyjeve në AKM, Fakultetit të Shkencave Pyjore Tiranë dhe konsulentëve suedeze të SLU & FSA (Universiteti Bujqësor i Upsalës dhe Agjencia e Pyjeve Suedeze).

Workshopi u fokusua në teknikën statistikore të përpunimit të të dhënave të terrenit, të fazës së parë të matjeve të vitit 2018. Gjatë javës trajnuese u bë i mundur përfundimi i përpunimit statistikor të të dhënave, si dhe një analizë paraprake e tyre. Disa rezultate paraprake u prezantuan në Konferencën e datës 19 mars 2019, në Hotel Tirana International, Tiranë, krahas qëllimit, rëndësisë dhe qëndrueshmërisë së procesit.

Për sa kohë mbeten edhe 30 % e numrit të klasterave për të kryer matjet, të dhënat e paraqitura në konferencë janë paraprake, ndaj dhe ne do të fokusohemi te disa nga më të rëndësishmet, duke i shprehur në përqindje, për tu konsideruar si informacion akoma i pazyrtaizuar e i pafinalizuar.

Grafiku 1. Siç tregojnë dhe ilustrimet grafike 46 % e territorit të vendit mbulohet nga pyjet, 19 % e zënë kullotat, ku pyjet në vetvete përbëjnë 2/3 e sipërfaqes së pyjeve dhe kullotave, kundrejt 1/3, që zënë kullotat.

Grafiku 2. Pjesa më e madhe e sipërfaqes pyjore mbulohet nga cungishte (34 %), vendin e dytë në sipërfaqe e zënë kullotat (30 %), dimërore e verore. Të tretët, për nga shtrirja, vijnë trungishtet (23 %), që pasohen nga shkurret (13 % të sipërfaqes, kundrejt totalit të sipërfaqes së pyjeve e kullotave në Shqipëri).


Grafiku 3. Pyjet e vendit tonë dominohen nga fletorët (66 % të totalit të tyre), ku 20 % e zënë pyjet halorët. Pyjet e përzierë,

me dominim fletorët, zënë një pjesë të vogël (rreth 6 %) dhe 8 % e zënë pyjet e përzierë halorë.

I gjithë procesi i IKPK-së pritet të përfundojë në fund të vitit 2019. Pra do të përfundojë matja në të gjitha klasterat e klasifikuar pro inventarit, si dhe përpunimi e analiza statistikore e të dhënave të grumbulluara.

Rezultati kryesor i IKPK-së është statistikor, ku të dhënat e mbledhura përdoren në analiza të ndryshme të gjendjes, shpërndarjes e ndryshimeve të pyjeve dhe kullotave në shkallë vendi, duke i ofruar politikës dhe vendimmarrësve informacionin e nevojshëm rreth përdorimit të qëndrueshëm të burimeve pyjore. Synimi i AKM-së, si drejtuese e këtij procesi, është shndërrimi i tij në një sistem të qëndrueshëm monitorimi për pyjet, ku rëndësi tepër të veçantë merr ngritja e kapaciteteve dhe vazhdimësia e procesit.


Të nderuar lexues, në këtë shkrim të shkurtër do të donim vetëm tu informonim shkurt për ecurinë e procesit të inventarit në këtë fazë të ndërmjetme të matjeve të terrenit, duke iu premtuar informacion të vazhdueshëm, deri në mbërritjen e rezultateve përfundimtare të këtij inventari. Deri atëherë, çdo interpretim të dhënash do ishte i parakohshëm dhe larg realitetit.



Grafiku 1



Grafiku 2



Grafiku 3

Në Maqedoninë e Veriut Një udhëtim në rrugën Mavrovë-Strugë

Katër liqene, pesë male, dy lumenj, dy qytete, fshatra, manastire, ura, natyra e bukur ... të gjitha këto në vetëm pak kilometra, në rrugën Mavrovë-Strugë, përkaj kufirit perëndimor të Maqedonisë së Veriut. Rruga nuk është e lehtë, ka shumë kthesa, në disa vende edhe e ngushtë, në disa vende ka edhe gurë apo dëme në asfalt. Për shkak të kësaj, shoferët shpesh i shmangen kësaj rruge. Por, nëse jeni pasagjer, do të kënaqeni. Ja disa pamje që do tu mben në kujtesë nga ky udhëtim në këtë rrugë piktoreske.

Km 1: **Pyll ah.** Rruga mund të quhet Mavrovë-Strugë, por fillon dhjetëra kilometra para Mavrovës, ku devijon nga

rruga kryesore Shkup-Ohër. Pylli i ahut u ndjek nga hapi i parë, me pemët me ngjyra e gjethe të gjelbra.



Km 8: **Liçeni i Mavrovës.** Prej këtu fillon vështrimi i parë i akumulimit artificial më të fotografuar në Maqedoni, i krijuar në vitin 1947, kur është ndërtuar diga dhe u bë pjesë e sistemit hidroenergjetik në vend.



Km 11: **Bujtina e Mavrovës.** Një rrugë tërësisht në shërbim të udhëtarëve, me restorante, shitore, pompa benzine e zona pushimi.



Km 20: **Radika.** Pamja e parë e lumit më të bukur e të pastër në Maqedoni, vjen te ura, përmes së cilës shkon në malin Korab. Harmoni e përsosur e ujit të shpejtë dhe të pastër, me shkëmbinj, pyje të dendur dhe bimë me gjethe të gjera edhe gjysmë metri.



Km 50: **Qendra Zhupë dhe Koxhaxhik.** Ndjekësit e Mustafa Kemal Atatürk-ut me siguri nuk do të pengohen të kalojnë 17 km përgjatë bregut lindor të liqenit të Dibrës, në një rrugë që paraqet sfidë më vete, deri në Koxhaxhik, vendlindjen e babait të tij, ku është edhe shtëpia muze kushtuar paraardhësve të tij.



Km 60: **Liçeni i Dibrës.** Edhe pse liqenin do ta shihni shumë herët (që nga Kosovrastit), peizazhet më të bukura janë rreth pesë kilometra në jug të Dibrës.



Km 79: **Gryka e Drinit të Zi.** Lumi i dytë në këtë rrugë është Drini i Zi. Edhe ky kalon përmes maleve dhe krijon grykë spektakolare.



Km 87: **Globoçica.** Uji në këtë liqen artificial është i errët, ndërsa rrethi është aq i qetë, që njëkohësisht mahnit dhe frikëson. Fshati i vjetër, që u përmbyt kur u ndërtua diga, nuk mund të shihet, por historia e saj vetëm rrit mistikën.



Km 107: **Struga.** Destinacioni i fundit. Qyteti i poezisë, i urave, i lumit Drin dhe liqenit të Ohrit do ta presë udhëtarin e lodhur me gjithë zemër.





Foresters live in communion, like the forest cluster

- Meditation, on the occasion of 16th February - Forest Engineer's Day -

By Kristo KAURI



among the mountains, hugging the reddish dawns and the golden west, creates this privilege. The "book" of nature is the

It is very good to read that he teaches many things, but to have clear ideas and concepts for the profession of forest engineer, the best method is to study and face the knowledge of nature in the forests.

Let's take the hat off scientists, Theophrastus, Goethe, Darwin, Line ... for their deeds and contributions to recognize nature. But to know the trees and the forest, their mystical and magical world, we must climb the mountains. Only

clearest, the most accurate to read, if you desire ... A young man or a young woman to become a forester, a forest engineer, needs to ascend mountains willingly, observe, to study in every season and every hour the nature. By observing nature, its beauty, landscapes,

communicating with the green Kingdom, absorbing pure oxygen, the heart and the soul are shaken and, naturally, you will thank the Lord for the joy and happiness it offers. Who does not taste or enjoy these magical emotions, in my opinion it is better not to become a forester and, if it is, to change profession sooner ...

Page 1, 3



Forests at stake

The International Conference, held from 12 to 15 February this year at the University of Warsaw (Poland), had two main goals:

- First, to emphasize the urgent need for forest conservation.
- Secondly, to emphasize the versatility of this issue and the crucial importance of preserving natural forests around the world.

The conference was organized in several sections and in each section 4-6 papers were held. In section 4 "Forest conservation policy" was presented the presentation "Beech forests in Albania" by Dr. Abdulla Diku, head of the association "Iliria", prepared in cooperation with



Prof. As. Lulezim Shuka and Dr. Admir Seci. In the discussions about this presentation was a lot of interest from the participants about the state of Albanian forestry and mainly for the beech forests...

By Gjon FIERZA

Page 2

Holy oak wood

So many have glorified the Lys Albanians as they have seen as a symbol of sustainability and human virtues! It is enough to notice the old towers in our Mountains, with the cattle-bird cage, just enough to look at the means of transport, carts and carts, soil gutters, etc. "Çardakët" of the towers have been carved from oak wood ...

Page 4



National Forest Inventory 2018-2019

- Processing the data of the first phase of the field, the next challenge -

Kliti STARJA - Bilena HYSENI

It took more than two and a half years for the NEA team to lead the capacity building project and the implementation of the National Forest and Pasture Inventory 2018-2019. On this journey, together with 18 specialists from the regional RAPAs, assisted by the Swedish FSA & SLU team, with World Bank funding, in addition to the achievement of the objectives, faced several difficulties and challenges in succession. Wanting to inform the public about the National inventory process, through this article we will try to redirect issues of broad interest, but also technical ones, to forest specialists who are awaiting the results of this venture, as challenging as even difficult.

The National Inventory of Forests and Pastures provides accurate information about the size, distribution, composition and condition of forests and pastures. These data also highlights the dynamics of the differences between two or more inventories and serve as a full statistical basis for other inventories in the future.

In the previous articles we have followed the work done to increase the capacities of the NFPI team, as well as the fulfillment of a number of technical and organizational conditions that precede the fieldwork and statistical processing of the data collected during the first phase of the measurements (June-October 2018). The digital data collection and transfer format "OPEN FORIS" improves data collection and recording, as well as facilitates the statistical processing process, avoiding many possible errors compared to the manual method ...

Page 1, 5



The role of the owners in improving the chestnut of Tropoja

By Shpend NIKOÇI

Chairman of the Association "Chestnut of Tropoja"

The chestnut tree in Tropoja requires their renewal. But renewal presents a lot of difficulty, as it necessarily requires climbing to the heights, requires high qualification and technical protection for workplace accidents. Chestnuts in Tropoja, like all the old chestnuts in the world, are threatened by fungal diseases, pests and parasitic and semi-parasitic plants, natural factors, as well as uncontrolled and uncontrolled community activity, illegal logging, fires ...



Page 7

Notification!

The editorial board of the "Kurora e Gjelbër" newspaper has drafted a project for the reprinting of the major work "The trees and the shrubs of Albania" by the author of Old Scientific Associate Ilia MITRUSHI, preserving the authorship. The reprint will be done under the care of a special editing. We invite the Faculty of Forestry Sciences, the National Environment Agency (Forestry Directorate), the Forestry Sector at the Ministry of Tourism and Environment, the World Bank, REC, CNVP, INCA, Forestry Companies, NAPA, the Environmental Services Project, etc., to unite the contributions for the republication of this very important work for today and for the future.

For the perpetuation of the figure of unforgettable scientist Ilia MITRUSHI, with the revenue from the sale of this book will be used to create a forest with his name.

The newspaper "Kurora e Gjelbër"

Cel. 068 42 17 939

klubiekologjik@gmail.com

Kontakttoni:

velihoxha@yahoo.com - 068 21 42 098

Klubi Ekologjik, Lezhë
klubiekologjik@gmail.com

Nr. Illogarie: 0110154266